

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Elite Support" Sh.p.k

KREU I:

ORTAKET- EMERTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHEZGJATJA

Sot me date 29.09.2021, themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"Elite Support" Shpk.**

Themelues i shoqerise Elite Support Shpk eshte Z. Shuster Gega, shtetas shqiptar, i datelindjes 14.02.1996, lindur dhe banues ne Tirane, me numer personal ID J60214056N, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;

Ky Statut krijohet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise nr. 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.

Neni 1

Emertimi dhe Forma Ligjore

1.1 Shoqeria tregtare eshte shoqeri vendase dhe emertohet **"Elite Support"** shpk, emertim i cili do të jete i stampuar dhe ne vulen e shoqerise.

1.2 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.), ne baze te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e Asamblese se Pergjithshme sipas parashikimeve ligjore te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 2

Objekti i veprimtarise

Veprimtari ne fushen e reklamave, Telemarketing, mirmbajtje software, hardware, informacion teknologjik, online marketing, Import - Eksport.

Neni 3

Selia e shoqerise

Selia e shoqerise shoqerise eshte ne adresen: Rruga: "Andon Zako Çajupi", Pallati Conad, Kati 2, Njesia Administrative Nr.5, Tirane.

Shoqeria ka te drejte te krijojë dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise ose jashte saj. Me vendim të Asamblese se Pergjithshme, mund të krijohej ose anullohej (ne rast se jane celur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashte saj. Njesite e tjera strukturore të shoqerise si dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohej kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.



Neni 4

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 5

Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është 600.000 (gjashtëqind mijë) leke.

Lloji i kontributit është në përputhje me vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) leke, i ndarë në 1 kuotë si më poshtë:

Z. Shuster Gega, është zotues i 1 (një) Kuotë, që i korrespondon 100 % (njëqind për qind) të Kapitalit të Shoqërisë.

Kapitali themeltar i shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortakët i shoqërisë.

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

Neni 6

Transferimi i kapitalit

6.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

6.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

6.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 7

E drejta e parablerjes

Transferimi për çdo arsye, tërësisht ose pjesërisht i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë është subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të ortakut tjetër, i cili mund të ushtrojë këtë të drejtë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me letër rekomandë, i cili përmban cmimin, blerësin e mundshëm dhe mënyrën e pagimit.

Në rast se ortakët nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se ka hequr dorë prej të drejtës së parablerjes.

Në rastin e mosushtimit të së drejtës së parablerjes nga ortakët, Ortakët që do të shesin kuotat duhet të njoftojë emrin e blerësit dhe kushtet të cilat nuk duhet të jenë më të favorshme se sa ato të ofruara ortakut tjetër të shoqërisë.

Neni 8

Organet e shoqërisë

Organi vendimarrës i shoqërisë "Elite Support" Shpk është Asambleja e Ortakëve e përbërë nga ortakët e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;



- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901, date 14.04.2008, nga ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit për shoqëritë tregtare.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 10

Mënyra e thirrjes

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsive.

Neni 11

Kërkesa nga ortakët e pakicës

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të ligjit për shoqëritë tregtare.

Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 14 të statutit.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

Neni 12

Përfaqësimi në asamble

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 13

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 14

Marrja e vendimeve

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin

81 të ligjit për shoqëritë tregtare, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 15

Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 16

Administratori

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar administrohet nga një ose disa persona fizike. Administratori i shoqërisë emrohet me vendim të ortakut të shoqërisë. Afati i qëndrimit në detyrë të administratorit të shoqërisë është për një periudhë 5 (pese) vjetore. Administrator i kësaj shoqërie caktohet Z. Shuster Gega.

Administratori i shoqërisë i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që u njeh ligji shprehimisht Asamblesë së Ortakëve ose të tregëve. Administratorët kanë përgjegjësi ndaj shoqërisë ose ndaj të tregëve për shkeljet e ligjeve, statutit apo shkeljeve të kryera gjatë administrimit. Administratori në rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogaritë vjetore etj.

Neni 17

BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

Viti fiskal fillon në 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor të çdo viti.

Për nxjerrjen e rezultatit kontabel të shoqërisë, mbi bazën e aktivitetit dhe pasivitetit, ngarkohet nga Asambleja e Përgjithshme një ekspert kontabel i autorizuar.

Neni 18


Ekspertët kontabel të autorizuar

Auditimi i brendshëm i Shoqërisë do të bëhet nga ekspertët kontabel të autorizuar, të caktuar për një vit fiskal. Ekspertët kontabel të autorizuar emrohen nga Asambleja e Përgjithshme me vendim të zakonshëm.

Neni 19

Nxjerrja e rezultateve të Bilancit vjetor duhet të bëhet me saktësi dhe duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen në Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, që janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt privat, që ushtron veprimtari tregtare.

Kontabiliteti mbahet në gjuhën Shqipe, në monedhën Shqiptare dhe pasqyrohet në librat përkatës. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të vecanta në valute. Shoqëria mund të marrë financime nga ortakët, institucione



financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte saj. Per kete qellim shoqeria mund te jape si garanci barre mbi pjeset e kapitalit ose sende te paluajtshme, me autorizim te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 20

Bilanci Kontabel vjetor miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaket, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

Neni 21

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Asamblea percakton pjesen qe iu takon ortakeve ne forme dividendesh.

Neni 22

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :

- a) me vendim te Asamblese se pergjithshme
- b) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- c) me hapje e procedurave te falimentimit
- d) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Neni 23

Cdo mosmarreveshje apo konflikt qe mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht, ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne te kunderten kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

Neni 24

Per cfare nuk eshte shprehur ne kete statut, do te rregullohet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe udhezimet plotesuese dhe të ligjshme të dhena nga Asambleja e Pergjithshme.

Neni 25

Ky statut u redaktua ne 4 origjinale ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlere te njejte juridike.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Elite Support" SHPK

Shuster Gega

